



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1127/6 prot.

Datë 11.05.2026

V E N D I M

Nr. 619/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.05.2026 u shqyrtua ankesa me

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Fred Electronic” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-79574-03-18-2026, me objekt: “Shpenzime për mirëmbajtjen e qarqeve të ndriçuesve Led”, me fond limit 3,332,100 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 30.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik.

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, me adresë: Rruga “5 Maji” , Tiranë

Ankimues: Operatori ekonomik “Fred Electronic” SHPK me NIPT (K91803020F) me adresë: Rruga e Kavajës, Pallati 207, Shk.2, Tiranë

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i

ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 19.03.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-79574-03-18-2026, me objekt: “Shpenzime për mirëmbajtjen e qarqeve të ndriçuesve Led”, me fond limit 3,332,100 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 30.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik.

II.2. Në datën 31.03.2026 autoriteti kontraktor ka përfunduar fazën e vlerësimit të ofertave. Ofertuesit janë njoftuar elektronikisht si vijon:

- | | |
|----------------------------|------------------------------|
| 1. “Eisi Hysa” p.f | 3.010.600 lekë, kualifikuar |
| 2. “Fredy Electronic” SHPK | 2,689,200 lekë, skualifikuar |

Arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Fredri Electronic” SHPK nga KVO-ja, janë si më poshtë vijon:

“FREDI ELECTRONIC” sh.p.k nuk ploteson pikën

➤ **2.3.1 Kapaciteti teknik:** 1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.....pasi lidhur me dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik **“FREDI ELECTRONIC”sh.p.k** në përmbushje të kriterit për shërbime të mëparshme të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit ka dorezuar ne SPE :

1. Fatura te ngjashme FONDACIONI "ËORLD VISION ALBANIA"
2. Fatura te ngjashme KONTROLLI LARTE SHTETIT
3. Fatura te ngjashme PC STORE
4. Fatura te ngjashme MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE
5. Fatura te ngjashme ERZENI/SH
6. Fatura te ngjashme ARIS ALBANIA
7. Fatura te ngjashme ALBANA KASMI
8. Fatura te ngjashme Albana Kasmi PF
9. Fatura te ngjashme Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
10. Fatura te ngjashme Osmani PF
11. Fatura te ngjashme PC STORE
12. Fatura te ngjashme Gazmend Beta
13. Fatura te ngjashme S I R E T A 2F
14. Fatura te ngjashme Departamenti për Teknologjinë e Informacionit
15. Fatura te ngjashme ALBANA KASMI pf
16. Fatura te ngjashme Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
17. Fatura te ngjashme Departamenti për Teknologjinë e Informacionit
18. Fatura te ngjashme Eva Kosti
19. Fatura te ngjashme ADRIATIK OSMANI
20. Fatura te ngjashme K U V E N D I
21. Fatura te ngjashme ASI INVEST

KVO konstaton nga analizimi i dokumentacionit ngarkuar ne SPE për faturën me Nr 14/2024 dhe faturën Nr 22/2026 OE FREDI ELECTRONIC”, nuk e plotëson vlerën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor për PIKEN 2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.....pasi nga shqyrtimi i zërave të faturave rezulton se OE • FREDI

ELECTRONIC” nuk ka përvojë të mëparshme ne asnjë zë të preventivit të shërbimeve të kërkuara nga autoriteti kontraktor që dëshmon se disponon eksperiencën e nevojshme për mirëmbajtjen qarqeve të ndriçuesve Led”, me qëllim riparimin dhe mirëmbajtjen e tyre dhe kthimin e tyre ne funksionalitet, në funksion të përmbushjes së detyrave të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, referuar specifikimeve teknike dhe shërbimeve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Mirëmbajtja e qarqeve të ndriçuesve Led është specifike dhe nuk është e ngjashme me artikujt e përshkruar ne faturat e ngarkuara ne SPE janë te ndryshme me mirëmbajtjen e qarqeve të ndriçuesve Led....”

II.3. Në datën 07.04.2026 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit të procedurës së prokurimit në SPE.

II.4. Në datën 10.04.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik, me nr. A/2026/6512, protokolluar me nr.1127/2026 prot, datë 14.04.2026, i operatorit ekonomik “Fred Electronic” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Fred Electronic” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Konkretisht pretendohet si vijon:

“Oferta e dorëzuar nga operatori ekonomik Fredi Electronic sh.p.k me vlere oferte 2,689,200 (Dy milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e dyqind) lekë (pa TVSH), eshte skualifikuar në mënyrë të padrejtë nga Komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO) në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik dhe kriteret e vendosura në DT. Arsyeja e skualifikimit të ofertës tonë sipas KVO është si më poshte: KVO konstaton nga analizimi i dokumentacionit ngarkuar ne SPE për faturën me Nr 14/2024 dhe faturën Nr 22/2026 OE FREDI ELECTRONIC, nuk e plotëson vlerën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor për PIKEN 2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.....pasi nga shqyrtimi i zërave të faturave rezulton se OE ? FREDI ELECTRONIC nuk ka përvojë të mëparshme ne asnjë zë të preventivit të shërbimeve të kërkuara nga autoriteti kontraktor që dëshmon se disponon eksperiencën e nevojshme për mirëmbajtjen qarqeve të ndriçuesve Led , me qëllim riparimin dhe mirëmbajtjen e tyre dhe kthimin e tyre ne funksionalitet, në funksion të përmbushjes së detyrave të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, referuar specifikimeve teknike dhe shërbimeve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Mirëmbajtja e qarqeve të ndriçuesve Led është specifike dhe nuk është e ngjashme me artikujt e përshkruar ne faturat e ngarkuara ne SPE janë te ndryshme me mirëmbajtjen e qarqeve të ndriçuesve Led.

Lidhur me këtë arsye kundërshtojme si vijon:

AK ne dokumentat e tenderit , konkretisht ne piken 2.6 te njoftimit te kontrates ka percaktuar si vijon: 1.Autoriteti Kontraktor ushtron një veprimtari të gjerë në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë, ku përfshihen jo vetëm zonat urbane por edhe të gjitha territoret e ish-komunave, pra zonat rurale.Objekti i veprimtarisë së Autoritetit Kontraktor përfshin, ndër të tjera, mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit publik. Riparimi i qarqeve ka si qëllim përmirësimin e rrjetit si dhe zëvendësimin e pjeseve te ndryshme perberese te nje sistemi ndricimi. Problematikat kane natyre te perseritur dhe jane te lidhura me llampat, droselat, me pjeset komanduese, instalacionit dhe infrastruktures kabllore. Për të minimizuar kostot në zëvendësimin e gjithë ndriçuesit A.K do të bëjë riparimin e qarqeve dhe transformatorëve. Si rrjedhim, riparimi i qarkut Led si dhe i transformatorit do të instalohen apo montohen njëkohësisht dhe në mënyrë paralele ne nje sistem ndricimi dhe furnizimi i kërkuar nuk mund të copëzohet.Në funksion të realizimit me sukses të detyrave të tij gjykohet se vetëm marrëveshja kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara është e përshtatshme. Për shkak të arsyeve teknike dhe organizative të përmendura më lart, lëvrimi i mallit nga operatorë të ndryshëm nuk është i favorshëm, sepse do të shkaktonte vështirësi AK-së duke u shoqëruar me kosto shtesë, vonesa në kryerjen e furnizimit dhe si rezultat mosrealizimin e punëve sipas objektivave të AK-së. 2.Ndryshimi i OE në rast se kjo marrëveshje do të lidhej me disa OE (pra rrjedhimisht ku jo të gjitha kushtet do të ishin të përcaktuara) do të shkaktonte kosto shtesë, pasiguri dhe konfuzion për OE të suksesshëm, gjë që do të shoqërohej me rritjen e afateve të lëvrimit duke patur parasysh nevojën për këtë mall nga ana e AK-së. Lidhja e MK me një OE të vetëm, do të shoqërohej me mirëorganizimin e këtij të fundit për sigurimin e mallit në kohë sipas kërkesave dhe nevojave të AK-së. Me tej tek shtojta 6, formulari i specifikimeve teknike AK ka kërkuar si vijon: Një qark LED (diodë elektrolumineshente) është një komponent elektronik që përdoret për të shfaqur dritë. Në përgjithësi, një qark LED përbëhet nga disa pjesë kryesore: Dioda LED: Pjesa kryesore e një qarku LED është dioda LED vetë. Kjo është pjesa aktive e qarkut dhe është ajo që prodhon dritë kur një voltazh i caktuar aplikohet në të. Paketa: Diodat LED janë të vendosura në një paketë ose një mbajtës, që i mbrojnë ato nga dëmtimet mekanike dhe ju lejojnë të lidhen me pjesët e tjera të qarkut. Kontakte: Qarku LED ka kontakte elektrike që lidhin diodën me burimin e energjisë (bateri, burim energjie, ose qarku elektrik). Pajisje për kontroll: Në disa raste, një qark LED mund të përfshijë pajisje për kontroll si rezistorë për të kufizuar rrjedhën e rrymës, ose tranzistorë për të ndryshuar dritën në bazë të sinjalit elektrik që merr. Në rast të dëmtimit të elementeve të një qarku LED, është e rëndësishme të ndërmerreni veprime të nevojshme për riparimin ose zëvendësimin e tyre. Kjo përfshin riparimin e kontakteve, si dhe pajisjet e kontrollit si tranzistorë dhe rezistorë. Po ashtu, duhet të riparohen edhe urat lidhëse midis diodave.

1.---- 2.---- Qark Ledi Tipi 1 Modeli: COB-2 50W Tensioni : 160-180V Rryma: 300mA Ngrohësia: 3000K Permasat: 40x46mm Qark Ledi Tipi 2 Modeli: COB-1 70W Tensioni : 50V Rryma: 2400mA Ngrohësia: 3000K Permasat: 74x78mm 3.---- 4.---- 5.---- 6.---- 7.---- Qark Ledi Tipi 3 Modeli : ND2Ë757GRT-V4-72 100W Ngrohësia: 3000K Tensioni: 150-160V Rryma: 800mA Permasat: 150x250mm Qark Ledi Tipi 4 Modeli COB-3 7Ë Ngrohësia: 3000K Tensioni: 150-160V Rryma:

300mA Permasat: 70x70mm Qark Ledi Tipi 5 Modeli: NVSË219FT-V2-12 30W Ngrohësia: 3000K Tensioni: 150-160V Rryma: 500mA Permasat: 45x145mm Qark Ledi Tipi 6 Modeli : LED COB High Lumen LED Chio Matrix 50W Ngrohësia: 4000K Tensioni: 220V Permasat: 70X70mm Qark Ledi Tipi 7 Modeli : LED COB High Lumen LED Chio Matrix 100W Ngrohësia: 4000K Tensioni: 220V Permasat: 100x110mm Një transformator është një pajisje elektrike që përdoret për të transferuar energjinë elektrike nga një qark në tjetrin duke përdorur induksionin elektrik. Pjesët kryesore të një transformatori përfshijnë: ? Bobina Primare: Bobina primare e një transformatori është pjesa e cila merr tensionin hyrës ose burimin e energjisë elektrike dhe e transformon atë në një fushë magnetike. Ky proces ndodh kur tensioni i aplikuar në bobinën primare ndryshon, për shkak të prizmit në rrjetin elektrik ose burimeve të tjera elektrike. ? Bobina Sekondare: Bobina sekondare e një transformatori është pjesa që merr tensionin e prodhuar nga fusha magnetike e krijuar nga bobina primare dhe e transformon atë në një tension të përshtatshëm për përdorim. Ky proces ndodh kur një tension elektrik ndërhyr në brendësi të bobinës sekondare, i shkaktuar nga ndryshimet në fushën magnetike të krijuar nga bobina primare. ? Terminalët: Këto janë pikat ku kabllot të jashtme lidhen me bobinat primare dhe sekondare të transformatorit për të furnizuar dhe marrë energjinë elektrike. Në rast të dëmtimit të transformatori, është e rëndësishme të ndërmerren veprime të nevojshme për riparimin ose zëvendësimin e pjesëve përbërëse të saj. Kjo përfshin riparimin e terminaleve, bobinën primare dhe sekondare të saj, rezistencave, tranzistorëve që ndodhen brenda transformatorëve. 1. Transformator Tipi 1 ----- 2.----- 3.----- Modeli: GD-FZ0051A 50W IP65 Tensioni ne Hyrje: AC 175-265V Frekuenca: 50-60Hz Tensioni ne dalje: DC 85-175V Rryma ne dalje : 300mA?5% Permasat: 78x30x20mm Max ? :94 Transformator Tipi 2 Modeli GD-FZ0086A 70W IP65 Tensioni ne hyrje: AC 170-265V Frekuenca: 50-60Hz Tensioni ne dalje: 120-160V Rryma ne dalje : 500mA?5% Permasat: 98x36x30mm Transformator Tipi 3 Modeli GD-FZ0101A 100W IP65 Tensioni ne hyrje: AC 170V-265V Frekuenca: 50-60Hz Tensioni ne dalje: DC 120- 160V Rryma ne dalje: 600mA?5% Permasat 115x29x22mm Ne shtojshen 7, tek formulari i shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit, përcaktohet: NR Emertimi Njesi Sasia 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 Qark Ledi Tipi 1, 50W, 3000K, Input 160-180V, 300mA cope Qark Ledi Tipi 2, 70W, 3000K, Input 50V, 2400mA Qark Ledi Tipi 3, 100W, 3000K, Input 150-160V, 800mA cope Qark Ledi Tipi 4, 7Ë, 3000K, Input 150-160V, 240mA Qark Ledi Tipi 5, 30W, 3000K, Input 150-160V, 500mA cope Qark Ledi Tipi 6, 50W, 3000K, 220V Qark Ledi Tipi 7, 100W, 3000K, 220V Transformator Tipi 1 Modeli 50W Transformator Tipi 2 Modeli 70W Transformator Tipi 3 Modeli 100W 250 cope cope cope cope cope cope cope 100 100 250 160 250 110 250 300 110 Ndersa ne piken 2.3 te kapacitetet tekn, lidhur me eksperiencen e meparshme te ngjashme Ak ka kerkuar: 1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme: a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të

plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të e shërbimeve të kryera, b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të e shërbimeve të kryera. Bazuar sa më sipër, në përmbushje të këtij kriteri në si OE kemi dorëzuar në SP fatura/ vertetime me objekt shitje malli dhe ose shërbimi me natyrë të ngjashme konkretisht:

? Fatura nr. 5/2025, FV për shërbime monitorimi subjektit Arlis Albania në vlerë 7 770 euro ose leke 734 265 leke (pa TVSH). ? Fatura 14/2024 me vlerë 476 400,00 leke (pa TVSH), fatura 22/2026 me vlerë 1 081 066,66 ALL me objekt shitje malli të ngjashëm me mallin objekt prokurimi me subjekt Albana Kasmi , ? Fatura 35/2025, me vlerë 585 311,17, me objekt shitje malli të ngjashëm me mallin objekt prokurimi, ? Fatura 20/2024 me vlerë 95 833 leke, me objekt shërbim sitem audio për konferencë + instalim për ambiente të brendshme + sistem led me FONDACIONI ËORLD VISION ALBANIA ? Fatura për shitje malli të ngjashëm me mallin objekt prokurimi si shitje prizash, ushqyes, spote ndricimi, ndricues led, në vitin 2024/2025 me subjektin Eva Kosti, Sireta 2 F, Erzeni SH, Gazment Beta, ? Fatura shitje shubjektit PC Store 30-08-2025 , Numri: 62/2025, me vlerë 333,300.00 leke (pa TVSH) për shitje artikuj të ngjashëm me objektin e prokurimit, ushqyes, pjesë për reklama led, module led full color, kabull, amplifikator, etj ? Vertetim nr. 6941/1, datë 08.05.2024 + fatura me Ministrinë e jashtme për mirëmbajtje e sistemit të kamerave të vezhgimit për ambiente të jashtme , instalim sistemi me vlerë 293 000 leke pa TVSH ? Vertetim nr. 16917/1, datë 24.11.2023 + fatura me Ministrinë e jashtme për mirëmbajtje e sistem, it të kamerave të vezhgimit për ambiente të jashtme , shtese memorie me vlerë 238 000 leke pa TVSH ? Fatura 3/2025 me vlerë 614 420 leke , me objekt shitje malli të ngjashëm me mallin objekt prokurimi paisje elektrike me subjektin Martini Konstruktion & Real Estate . ? Vertetim + Fatura 38/2023 me Kuvendin me objekt Materiale të ndryshme mirëmbajtjen specialiteti elektrik Me vlerën 1380575 leke pa tvsh dhe fatura të tjera për kryerje shërbimi apo furnizim malli (IT/Elektrike).

Ju sjellim në vëmendje se referuar vetë njoftimit të AK citohet se ...Problematikat kanë natyrë të perseritur dhe janë të lidhura me llampat, droselat, me pjesët komanduese, instalacionit dhe infrastrukture kabllorë dhe me tëj citohet.....

Për shkak të arsyeve teknike dhe organizative të përmendura më lart, lëvrimi i mallit nga operatori të ndryshëm nuk është i favorshëm, sepse do të shkaktonte vështirësi AK-së duke u shoqëruar me kosto shtesë, vonesa në kryerjen e furnizimit dhe si rezultat mosrealizimin e punëve sipas objektivave të AK-së.

Sa më sipër, Kontrata objekt prokurimi, nuk ka as natyrë as kompleksitet apo metodologji të ndryshme, nga të gjitha kontratat e realizuara nga ana jonë dhe të paraqitura si të ngjashme në këtë procedurë prokurimi, pasi ashtu sic evidentohet dhe nga ana e AK me shume ka të bëjë me mall se sa me shërbim..

Vleresimi i bërë nga KVO duke e skualifikuar ofertën e OE Fredi Electronic sh.p.k. me argumentin se dokumentacioni ngarkuar në SPE për faturën me Nr 14/2024 dhe faturën Nr 22/2026 OE FREDI ELECTRONIC, nuk e plotëson vlerën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor pasi nga shqyrtimi i zërave të faturave rezulton se OE FREDI ELECTRONIC nuk ka përvojë të mëparshme në asnjë zë të preventivit të shërbimeve të kërkuara nga autoriteti kontraktor që dëshmon se disponon eksperiencën e nevojshme për mirëmbajtjen e qarqeve të ndriçuesve Led, me qëllim riparimin dhe mirëmbajtjen e tyre dhe kthimin e tyre në funksionalitet, në funksion të përmbushjes së detyrave të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, referuar specifikimeve teknike dhe shërbimeve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Mirëmbajtja e qarqeve të ndriçuesve Led është specifike dhe nuk është e ngjashme me artikujt e përshkruar në faturat e ngarkuara në SPE janë të ndryshme me mirëmbajtjen e qarqeve të ndriçuesve Led. Ky argumentim nga ana e KVO -se për refuzim nuk qendon dhe nuk është aspak profesional, është i pambeshtetur në ligj dhe totalisht në kundërshtim me frymën dhe parimet e Ligjit të Prokurimit Publik, pasi faturat/vertetimet e paraqitura nga ne jo vetëm plotësojnë vlerën e 20% të fondit limit në vlerë por edhe natyrën e funizimeve/shërbimeve të ngjashme. Autoriteti kontraktor ka cënuar rëndë parimet e sanksionuara në Ligjin nr.162/2020 Për Prokurimin Publik neni 2 i cili shpreh qëllimin e këtij ligji : a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Veprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim dhe me nenin 258 të K.Penal, i cili parashikon se: Kryerja nga personi i ngarkuar me funksione shtetërore apo në shërbim publik i veprimeve në kundërshtim me ligjet që rregullojnë lirinë e pjesëmarrjes dhe barazinë e shtetasve në tendera dhe ankande publike, për të krijuar avantazhe ose privilegje të padrejta për të tretët, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet . Format e kryerjes së kësaj vepre penale nga ana objektive janë dy: 1) pengimi i palëve për të marrë pjesë në tender/ankand dhe 2) vlerësim i pabarabartë i një kushti/disa kushteve të plotësuar nga të gjitha palët. Pra, vlerësimi i mësipërm është bërë qëllimisht nga Autoriteti Kontraktor, që pjesëmarrësit të mos jenë në kushte të barabarta konkurrimi, duke sjellë favorizimin e një operatori ekonomik dhe skualifikimin e ofertës tone,. Nga ana subjektive kjo vepër kryhet me dashje të drejtpërdrejtë dhe me qëllim për të krijuar avantazhe ose privilegje të padrejta për të tretët, nisur nga interesat materiale ose morale. Gjithashtu ne si OE gjykojmë të ndalemi në një analizë të thelluar të dëshmive të eksperiencës së ngjashme, të dorëzuar nga ana jone, parë kjo në rrafshin krahasimor me formularin e njoftimit të kontratës pika 2.6, formularin e specifikimeve teknike të kërkuara nga autoritetin kontraktor, si dhe kriterin për kualifikim të përcaktuar në pikën 2.3 të kriterëve të vecanta për kualifikim ku Ak ka kërkuar:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël

se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme: c) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të kryera, d) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të kryera.

Vete ligjvënasi e ka kushtezuar kriterin lidhur me përvojën e mëparshme me termin eksperiencë e ngjashme, jo eksperiencë identike/njejtë. Në kemi paraqitur fatura për furnizime të moduleve LED, transformatorëve, pajisjeve elektronike; shërbime instalimi të sistemeve LED Ëall; mirëmbajtje dhe instalim të sistemeve të kamerave (teknologji elektronike dhe energjie); shërbime audio-konferencë dhe video; furnizime të pajisjeve të ndriçimit dhe elektronikës. Të gjitha këto janë shërbime dhe furnizime janë të së njëjtës natyrë teknike si ato të kërkuara nga AK për mirëmbajtjen e qarqeve LED. Qarqet LED dhe transformatorët përbëhen nga dioda LED; tranzistorë; rezistorë; qark elektronik; stabilizatorë tensioni dhe për mirëmbajtjen e tyre kërkohen nderhyrje me njohuri teknike elektronike; instalime elektrike dhe zëvendësime komponentësh.

Operatori ynë ka ushtruar pikërisht këtë lloj ndërhyrjeje teknike në sistemet elektronike të kamerave, sistemeve audio-video, LED Ëall, furnizimit të moduleve LED, ndriçimit etj. Sa më lart, autoriteti kontraktor nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale, por të analizojë në thellësi dhe në mënyrë të arsyeshme e proporcionale eksperiencat e dokumentuara nga ana jone, në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilin vendosen kriteret e përcaktuara dhe nuk mund të na skualifikojë ne si OE që kemi eksperiencë të ngjashme në sektor elektronik, ndriçim, instalime dhe mirëmbajtje teknike; Vlerësimi i eksperiencës së ngjashme nuk duhet bërë sipas formulës së identitetit teknik, por në funksion të natyrës së shërbimeve dhe furnizimeve dhe të interpretohet në mënyrë proporcionale dhe jo kufizuese. Autoriteti Kontraktor ka interpretuar gabim DST-në duke tentuar ta trajtojë kontratën si shërbim të pastër mirëmbajtjeje, ndërkohë që vetë dokumentacioni kërkon furnizim komponentësh të specifikuar me model, fuqi, voltazh dhe dimensione. Për më tepër, në DST është përdorur termi furnizime të mëparshme të ngjashme, çka e bën të pavlefshëm pretendimin e AK se kërkohet vetëm eksperiencë në shërbim, ndërkohë që është furnizim + shërbim. Theksojmë se në nenin 2 qëllimi i ligjit nr. 162/2020 për prokurimin publikë, parashikohet shprehimisht se: qëllim I këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ndërkohe në nenin 3 parime të përgjithshme të ligjit nr. 162/2020

për prokurimin publikë, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me kushtetutën. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

Qëllimi i kushteve të përzgjedhjes (kualifikimit), është identifikimi i atyre operatorëve ekonomikë që janë të aftë të kryejnë dhe plotësojnë kontratën që do të fitohet. Autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë kërkesat që janë të barabarta për të gjithë operatorëtekonmikë. Kur vendos kushtet për pjesëmarrje, autoriteti kontraktor mund të përcaktojë nivelet minimale të kapacitetit që operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë, kur është e përshtatshme, duke përfshirë kapacitetet e palëve të treta. Këto kushte duhet të jenë të lidhura dhe proporcionale me objektin e prokurimit. Procesi i përzgjedhjes duhet të kufizohet në një vlerësim, nëse arsyet për përjashtim (të detyrueshme ose fakultative) janë përmbushur, si dhe një vlerësim të përshtatshmerisë së operatorit ekonomik për të kryer shërbimin, gjendjes së tij financiare dhe ekonomike, si dhe kapacitetit të tij teknik dhe/ose profesionale. Prokurimi publik është një ndër veprimtaritë kryesore të shtetit, ndaj jo rastësisht ligjvënësi ka parashikuar edhe 6 qëllime kryesore të ligjit: a) të rrisë efijencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimetprocedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimitpublik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim tëbarabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat eprokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat eprokurimit publik. Në parimet e përgjithshme të ligjit për prokurimin publik është parashikuar, si një risi e re në ligj edhe detyrimi i autoriteteve kontraktore që të shmangin cdo formëartificiale për të ngushtuar konkurrencën. Në kuptim të ligjit, konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. Autoriteti Kontraktor ka interpretuar gabim DST-në duke tentuar ta trajtojë kontratën si shërbim të pastër mirëmbajtjeje, ndërkohë që vetë dokumentacioni kërkon furnizim komponentësh të specifikuar me model, fuqi, voltazh dhe dimensione. Për më tepër, në DST është përdorur termi furnizime të mëparshme të ngjashme , çka e bën të pavlefshëm pretendimin e AK se kërkohet vetëm eksperiencë në shërbim. Kontrata është një kontrate e përzier furnizim shërbim; dhe eksperiencia jonë është e natyrës së ngjashme dhe ligjërish e vlefshme; Duke qene se dokumentacion i dorezuar nga ana

jone (vertetimet/faturat) e dorezuara kanë të njëjtën bazë teknike: instalim, furnizim dhe mirëmbajtje të pajisjeve elektronike që përfshijnë module LED, transformatorë, sisteme me qark elektronik, elementë furnizimi dhe komponentë të sistemeve të ndriçimit. Qarqet LED dhe transformatorët e kërkuar nga AK i përkasin të njëjtës kategori të punimeve me bazë elektronikën dhe energjinë. Kjo përputhje teknike vërteton plotësisht kriterin e eksperiencës së ngjashme. Vlerësimi i AK është teknikisht dhe juridikisht i gabuar dhe se skualifikimi ynë është i pabazuar dhe cënues i konkurrencës.

Në rastin konkret ku oferta e paraqitur nga ana është me çmim më të ulët në vlerën 2.689.200 lekë (pa TVSH) dhe me leverdi ekonomike, autoriteti kontraktor nuk mund te skualifikojë me pa të drejte.

Autoriteti kontraktor, duhet të udhëhiqet nga parimi i mirëpërdorimit të fondeve publike dhe përfitimi i një produkti me cilësi të mirë dhe me çmim më të ulët, si edhe nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale, aq më tepër në kushte kur kemi një përcaktim të qartë të kriterëve dhe dokumentacionit që duhet të paraqitet, dokumentacion ky i cili provohet më së miri nga oferta e dorezuar nga operatori ekonomik Fredi Electronic sh.p.k. Nepermjet dokumentacionit te paraqitur në këtë procedurë prokurimi oferta e operatorit ekonomik Fredi Electronic sh.p.k eshte nje oferte e përgjegjshme/vlefshme pasi ajo i plotëson kërkesat e përcaktuara ne Dokumentat e Tenderit, pa devijime materiale, rezerva ose mospranim, dhe nuk duhet të skualifikohet pasi është dhe me çmim më të ulët dhe me leverdi ekonomike per AK. Bazuar sa me siper, ne mbeshtetje te nenit 94 te VKM Nr. 285/2021 Per miratimin e rregullave te prokurimit publik si operator ekonomik, i cili kam pasur interes në procedurën e prokurimit ne reference dhe ne kushtet kur jam dëmtuar nga veprimet e kundraligjshme te KVO per refuzim te pa drejte te ofertes sone, në përfundim të shqyrtimit të ankesës i kerkojme AK bazuar ne nenin 114 , pika 3 te LPP -se si dhe nenin 102, pika 1/a dhe KPP bazuar ne nenin 103 pika pika 2/b , të vendosë, shfuqizimin e vendimit te KVO per refuzimin e pa drejte te ofertes se operatorit ekonomik Fredi Electronic sh.p.k dhe pranimin e plotë të ankesës si ankese e cila i mbeshtet pretendimet e veta ne ligj, fakte e prova.

Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik (KVO) të rivlerësojë ofertën tonë duke vlerësuar se ajo është në përputhje në atë çfarë është kërkuar në DT .

Për sa kemi argumentuar me sipër, referuar ligjit te prokurimit publik, akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, si dhe referuar kriterëve ne DT, i kërkojmë AK,

? Të shfuqizojë vendimin e Komisionit te Vleresimit te Ofertave si nje vendim antiligjor.

? Të kualifikojë ofertën e operatorit ekonomik Fredi Electronic sh.p.k

Theksojme se, argumentat e trajtuara me siper jane te bazuar ne ligj dhe ne prova sipas dokumentacionit të ofertes te dorezuar ne SPE. Nëse AK, KSHA si dhe KPP do te ketë nevojë të verifikojë dokumentacionin në forme shkresore që disponoj jam i gatshëm të bashkëpunojë në cdo kohë duke jua vënë në dispozicion ato.”

II.5. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1127/1 Prot., datë 16.04.2026.

II.6. Në datën 21.04.2026 është protokolluar në Komsionin e Prokurimit Publik me nr.1127/2 prot., Vendimi i Komsionit të Shqyrtimit të Ankesave nr.1270/11 prot., datë 21.04.2026. Referuar këtij vendimi rezulton se autoriteti kontraktor ka refuzuar pretendimet e operatorit ekonomik ankimues.

II.7. Në datën 22.04.2026 është protokolluar në Komsionin e Prokurimit Publik me nr.1127/3 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 1270/12 prot., datë 21.04.2026 me objekt: “*Kthim përgjigje*”, bashkëngjitur vendimi i KSHA-së si më sipër cituar.

II.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020, për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga ana e autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Fredy Electronic” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 9 “*Kriteret e vecanta të kualifikimit*”, “*Kapaciteti teknik*”, pika 2.3.1 në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të kryera,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të kryera.

III.1.2. Në shtojcën 6, 7 dhe 8 të dokumentave të tenderit të mësipërm të publikuara në SPE, rezulton se është parashikuar si vijon:

Shtojca 6 .

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Një qark LED (diodë elektrolumineshente) është një komponent elektronik që përdoret për të shfaqur dritë. Në përgjithësi, një qark LED përbëhet nga disa pjesë kryesore:

Dioda LED: Pjesa kryesore e një qarku LED është dioda LED vetë. Kjo është pjesa aktive e qarkut dhe është ajo që prodhon dritë kur një voltazh i caktuar aplikohet në të.

Paketa: Diodat LED janë të vendosura në një paketë ose një mbajtës, që i mbrojnë ato nga dëmtimet mekanike dhe ju lejojnë të lidhen me pjesët e tjera të qarkut.

Kontakte: Qarku LED ka kontakte elektrike që lidhin diodën me burimin e energjisë (bateri, burim energjie, ose qarku elektrik).

Pajisje për kontroll: Në disa raste, një qark LED mund të përfshijë pajisje për kontroll si rezistorë për të kufizuar rrydhën e rrymës, ose tranzistorë për të ndryshuar dritën në bazë të sinjalit elektrik që merr.

Në rast të dëmtimit të elementeve të një qarku LED, është e rëndësishme të ndërmerri veprime të nevojshme për riparimin ose zëvendësimin e tyre. Kjo përfshin riparimin e kontakteve, si dhe pajisjet e kontrollit si tranzistorë dhe rezistorë. Po ashtu, duhet të riparohen edhe urat lidhëse midis diodave.

1. Qark Ledi Tipi 1

- *Modeli: COB-2 50W*
- *Tensioni : 160-180V*
- *Rryma: 300mA*
- *Ngrohtesia: 3000K*
- *Permasat: 40x46mm*

2. Qark Ledi Tipi 2

- *Modeli: COB-1 70W*
- *Tensioni : 50V*

- Rryma: 2400mA
 - Ngrohtesia: 3000K
 - Permasat: 74x78mm
3. *Qark Ledi Tipi 3*
 - *Modeli : ND2W757GRT-V4-72 100W*
 - *Ngrohtesia: 3000K*
 - *Tensioni: 150-160V*
 - *Rryma: 800mA*
 - *Permasat: 150x250mm*
 4. *Qark Ledi Tipi 4*
 - *Modeli COB-3 7W*
 - *Ngrohtesia: 3000K*
 - *Tensioni: 150-160V*
 - *Rryma: 300mA*
 - *Permasat: 70x70mm*
 5. *Qark Ledi Tipi 5*
 - *Modeli: NVSW219FT-V2-12 30W*
 - *Ngrohtesia: 3000K*
 - *Tensioni: 150-160V*
 - *Rryma: 500mA*
 - *Permasat: 45x145mm*
 6. *Qark Ledi Tipi 6*
 - *Modeli : LED COB High Lumen LED Chio Matrix 50W*
 - *Ngrohtesia: 4000K*
 - *Tensioni: 220V*
 - *Permasat: 70X70mm*
 7. *Qark Ledi Tipi 7*
 - *Modeli : LED COB High Lumen LED Chio Matrix 100W*
 - *Ngrohtesia: 4000K*
 - *Tensioni: 220V*
 - *Permasat: 100x110mm*

Një transformator është një pajisje elektrike që përdoret për të transferuar energjinë elektrike nga një qark në tjetrin duke përdorur induksionin elektrik. Pjesët kryesore të një transformatori përfshijnë:

- *Bobina Primare: Bobina primare e një transformatori është pjesa e cila merr tensionin hyrës ose burimin e energjisë elektrike dhe e transformon atë në një fushë magnetike. Ky proces ndodh kur tensioni i aplikuar në bobinën primare ndryshon, për shkak të prizmit në rrjetin elektrik ose burimeve të tjera elektrike.*

- *Bobina Sekondare: Bobina sekondare e një transformatori është pjesa që merr tensionin e prodhuar nga fusha magnetike e krijuar nga bobina primare dhe e transformon atë në një tension të përshtatshëm për përdorim. Ky proces ndodh kur një tension elektrik ndërhyr në brendësi të bobinës sekondare, i shkaktuar nga ndryshimet në fushën magnetike të krijuar nga bobina primare.*
- *Terminalët: Këto janë pikat ku kablllo të jashtme lidhen me bobinat primare dhe sekondare të transformatorit për të furnizuar dhe marrë energjinë elektrike.*

Në rast të dëmtimit të transformatori, është e rëndësishme të ndërmerren veprime të nevojshme për riparimin ose zëvendësimin e pjesëve përbërëse të saj. Kjo përfshin riparimin e terminaleve, bobinën primare dhe sekondare të saj, rezistencave, tranzistorëve që ndodhen brënda transformatorëve.

1. Transformator Tipi 1

- *Modeli: GD-FZ0051A 50W IP65*
- *Tensioni ne Hyrje: AC 175-265V*
- *Frekuenca: 50-60Hz*
- *Tensioni ne dalje: DC 85-175V*
- *Rryma ne dalje : 300mA±5%*
- *Permasat: 78x30x20mm*
- *Max η:94*

2. Transformator Tipi 2

- *Modeli GD-FZ0086A 70W IP65*
- *Tensioni ne hyrje: AC 170-265V*
- *Frekuenca: 50-60Hz*
- *Tensioni ne dalje: 120-160V*
- *Rryma ne dalje : 500mA±5%*
- *Permasat: 98x36x30mm*

3. Transformator Tipi 3

- *Modeli GD-FZ0101A 100W IP65*
- *Tensioni ne hyrje: AC 170V- 265V*
- *Frekuenca: 50-60Hz*
- *Tensioni ne dalje: DC 120- 160V*
- *Rryma ne dalje: 600mA±5%*
- *Permasat 115x29x22mm*

Shtojca 7.

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen:

NR	Emertimi	Njesi	Sasia
1	Qark Ledi Tipi 1, 50W, 3000K, Input 160-180V, 300mA	cope	250
2	Qark Ledi Tipi 2, 70W, 3000K, Input 50V, 2400mA	cope	110
3	Qark Ledi Tipi 3, 100W, 3000K, Input 150-160V, 800mA	cope	250
4	Qark Ledi Tipi 4, 7Ë, 3000K, Input 150-160V, 240mA	cope	300
5	Qark Ledi Tipi 5, 30W, 3000K, Input 150-160V, 500mA	cope	110
6	Qark Ledi Tipi 6, 50W, 3000K, 220V	cope	100
7	Qark Ledi Tipi 7, 100W, 3000K, 220V	cope	100
8	Transformator Tipi 1 Modeli 50W	cope	250
9	Transformator Tipi 2 Modeli 70W	cope	160
10	Transformator Tipi 3 Modeli 100W	cope	250

Afatet e ekzekutimit: Duke filluar nga data e lidhjes së kontratës/kontratave me përfundim deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor.

Shtojca 8.

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Objekti i këtij shërbimi mirëmbajtjen dhe riparimin e qarqeve të ndriçuesve Led, me qëllim riparimin dhe mbajtjen e tyre dhe kthimin e tyre në funksionalitet, në funksion të përmbushjes së detyrave të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik.

Detyrat:

Operatori Ekonomik ka detyrimin të kryejë shërbimet me cilësi dhe në kohën e përcaktuar nga AK. Me përfundimin e riparimit, personi përgjegjës, i autorizuar pranë servisit, njofton Autoritetin Kontraktor, për përfundimin e riparimit, në mënyrë që të bëhet tërheqja pranë servisit.

Në përfundim të çdo punimi do të mbahet procesverbal mbi shërbimet e kryera, nga personat përgjegjës të të dy palëve.

Operatori Ekonomik ka detyrimin e rikryerjes pa pagesë të shërbimeve të riparimit, që rezultojnë të kryera nga ana e tij, jo sipas kushteve teknike dhe brenda afateve të garancisë, të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit.

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: Në ambientet e servisit të operatorit ekonomik fitues.

III.1.3. Nga verifikimi i kryer në sistemin e prokurimit elektronik, në përmbushje të kriterit të mësipërm, rezulton se operatori ekonomik “Fredy Electronic” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

1. Fatura elektronike nr. 20/2024, datë 19.03.2024, me blerës Fondacioni World Vision Albania, me vlerë 95.833 lekë, pa TVSH, me zërat: Sherbim Sistem Audio per konference + instalim per ambjent te brendshem; Sherbim LED Wall 4mm + instalim 12 m; Mikrofona Wireless per perkthim simultan
2. Shkresë “Kthim përgjigje” nr. 78/1 prot., datë 15.01.2025 nga KLSH, drejtuar “Fredy Electronics” SHPK, shoqëruar me faturat elektronike nr. 30/2024 me blerës KLSH me vlerë 98.000 pa tvsh për zërin “Kamera të jashme”; nr. 48/2024 me blerës KLSH me vlerë 10.625 pa tvsh për zërin “Mirëmbajtje system anti zjarr”; nr. 59/2024 me blerës KLSH me vlerë 10.625 pa tvsh për zërin “Mirëmbajtje system anti zjarr”; nr. 67/2024 me blerës KLSH me vlerë 10625 pa tvsh për zërin “Mirëmbajtje sistem anti zjarr”; nr. 94/2024 me blerës KLSH me vlerë 10625 pa tvsh për zërin “Mirëmbajtje sistem anti zjarr”.
3. Fatura nr.62/2024, datë 30.08.2025, me blerës “PC Store” SHPK, me vlerë 333.300 lekë pa TVSH, përmban zërat ushqyes 12 V, pjesë për reklame me LED, module LED fullcolor, kabell kamera, mixer dhe amplifikator aparature audio, amplifikator audio.
4. Fatura elektronike nr. 3/2025, datë 15.01.2025 me blerës “Martini Konstruksion & Real Estate” SHPK me vlerë 614.420 lekë,TVSH. Kjo faturë përmban zërat: KUTI JAShte MURIT bticino 3m; KABULL UTP CAT 6 metër linear; PRIZE SHUKO UNIVERSALE 16A E BARDHE clasia; PRIZE INTERNETI RJ45 clasia; FROR KABELL 3X2.5; KANALINE PLASTIKE ME NGJITJE 60*25 ME BRYLA DHE KENDE TE VETAT; EC-KUTI AUTOMATI 36MJ/M IP65 HERMETIKE jasht muri; KABELL5X10 FG160R16 5X10; AUTOMAT MAGNETO-TERMIK 49 50A; SALVAVITE 4P 40A; MORSETERI 4P 11 X 125A; LLAMPE SINJALI 3 FAZORE ME PIKA TE NDARA; AUTOMAT MAGNETO TERMIK 4P 6A C 6KA 74406; AUTOMAT MAGNETO-TERMIK 1P+N 16A 1modul; FAEG+VIDA+UPA FI-6; DEPA-FASHETA PLASTIKE 3.6X300 TE ZEZA; M-RAK 16 UNIT 600X800X600; RACK-RAFT TAVE PER RACK ME THELLESI 600MM; RACK-PATCH PANEL 24 PORTA FTP CAT6; RACK - ORGANIZATOR KABELL HORIZONTAL IU 19 INCH (PATCH GUIDE); PATCH CORD CAT6 0.5M; KABULL HDMI ME FIBER OPTIKE ME DY KOKA , 10 M
5. Fatura nr. 7/2024, datë 20.03.2024 me blerës “Erzeni/Sh” SHPK me vlerë 26.666 lekë pa TVSH për artikullin prize.
6. Fatura elektronike nr. 5/2025, datë 28.01.202, me blerës “ARIS Albania” SHPK , me vlerë 734.265 lekë pa TVSH për zërin: sisteme monitorimi.
7. Fatura elektronike nr. 14/2024, datë 28.02.2024 me blerës “Albana Kasmi” dhe vlerë 476.400 lekë pa TVSH për blerjen e artikujve ose shërbimeve si vijon: Module led; Module screen led; Module led fullcolor; Kasa alumini per ndricues led; Kasa alumin per ndricues Led.

8. Fatura elektronike nr. 3/2026, datë 07.01.2026 me blerës “Albana Kasmi” dhe vlerë 277.500 lekë pa TVSH për blerjen e artikujve vidioprojektor; prozhektor.
9. Vërtetim nr. 6941/1 prot., datë 08.05.2024, lëshuar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për kontratën me objekt: “Mirembajtje e sistemit të kamerave të vëzhgimit për ambimetet e brendshme dhe të jashtme , instalim sistemi” për shoqërinë “Fred Electronics” SHPK, shoqëruar me Faturën elektronike nr. 29/2024, datë 05.04.2024 me vlerën 293.000 lekë pa TVSH dhe zërat Pastrim, riparim, mirëmbajtje NVR.; Kamera 5mp, të jashtme; Switch, GB 16 porta; ushqyes 12V 20A; Kabllorë UTP 4x2 8 fije, cat 6 metër linear; Bllok ushqimi NVR; Fisha koka rrjeti; Kabull HDMI 5m; UPS; Priza, spina.; Riparim ekrani LED 50 inch.
10. Fatura nr. 28/2024, datë 21.11.2024 me blerës “Adriatik Osmani”, me vlerë 148.000 lekë për artikullin ndricues led.
11. Fatura nr. 49/2025, datë 19.07.2025 me blerës “PC Store” me vlerë 478.500 lekë për artikullin ekran led për stacione autobuzi.
12. Fatura nr. 27/2025, datë 08.07.2025 me blerës “Gazment Beta” me vlerë 1.800 lekë për artikullin ushqyes 200W/24V.
13. Fatura nr. 21/2024, datë 20.03.2024 me blerës “Sireta 2F” me vlerë 12.900 lekë për artikujt swich, ushqyes dhe bateri 12 V.
14. Vërtetim nr. 96 prot., datë 14.01.2026, lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme për kontratën me objekt: “Blerje material për pajisje radio komunikimi” për shoqërinë “Fred Electronics” SHPK, shoqëruar me Faturën elektronike nr. 64/2025, datë 08.09.2025 me vlerën 2.113.050 lekë pa TVSH me zërat Ushqyes per radio baze/reperitor; Antene UHF Omni direksionale; Antene UHF Yagi; Duplexer UHF me 6 kavitate; Kabell Koaxial RG 213U metër linear; Konektor per kabell RG213U tip N- male; Konektor per kabell RG213U tip N- female; [...]; Garniture radio stacionere Motorola [...],Antene radio dore Vertex EVX-531; Bateri radio dore Vertex EVX-531; Karikues bateri radio dore Vertex EVX-531; Kufje te jashtme; [...], ore Icom IC-F43GT; Cante me konektor adaptor; Mates fuqie digital; Fasheta plastike, metalike; Nastro elektrike, izoluese zifti;
15. Fatura elektronike nr. 22/2026, datë 25.02.2026 me blerës “Albana Kasmi” PF dhe vlerë 1.081.066 lekë pa TVSH për blerjen e artikujve Altoparlant FBT, professional; Tel bakrri 3x2.5 metër linear; Mikser metër linear; Mbajttese&stativa per bokse; Aksesore per reklama led; Ushqyes per ndricues led; Module led, ekrani; Kasa alumini [...].
16. Vërtetim nr. 16917/1 prot., datë 24.11.2023, lëshuar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për kontratën me objekt: Mirembajtje e sistemit të kamerave të vëzhgimit për ambimetet e brendshme dhe të jashtme , shtesë memorie” për shoqërinë “Fred Electronics” SHPK, shoqëruar me Faturën elektronike nr. 71/2023, datë 31.10.2023 me vlerën 238.000 lekë pa TVSH dhe zërat: Kamera 2mp, të brendshme, të jashtme; Hard disk për kamerat, Switch, GB 16 porta; Ushqyes 12V 20A; Linja kabllorë UTP 4x2 8 fije metër linear; Bllok ushqimi NVR; Fisha koka rrjeti.

17. Fatura nr. 21/2025, datë 30.06.2025, me blerës Eva Kosti dhe vlerë 23.665 lekë pa TVSH për blerjen e artikujve Aksesore, pjese TV; Fisha adaptore; Ushqyes Spoti, të vegjel; Mjete pune per teknike TV; spote ndricimi; Mikrofon Ëireless.
18. Fatura elektronike nr. 38/2025, datë 30.06.2025 me blerës Adriatik Osmani dhe vlerë 585.311 lekë pa TVSH për blerjen e artikujve Karte RJ 45PCI; Kompjuter; Karikues; Aksesore per panele ndricimi (Led module); Fisha ushqimi; Priza Shuko; Suporte per kuti; Percjelles i veshur; Kuti shperndarse; Bateri hermetike 12 V 7 Ah; CT-BNC-3PC-C59; Zgjatues; Izolant i vogë; Dryna te medhenje; Fasheta plastike; Kabell, Fisha ushqim; atak, spraj; Aksesore elektrike; koka rrjeti; Kufje PC; Bokse; Mbajtese gjalpi; Tabaka plastike, aksesore guzhine; kasete; Tel FS17 kundra/zjarrit 2.5 mm2 kaf metër linear; Berta smart Rack i bardhe OPAL 1xE27; silicon; bokse audio; Ups 20 KVA 3F/3F Tescom; aksesore.
19. Vërtetim nr. 2477/1 prot., datë 08.08.2023, lëshuar nga Kuvendi për kontratën me objekt: “Materiale të ndryshme mirëmbajtje specialiteti elektrike” për shoqërinë “Fred Electronics” SHPK, shoqëruar me Faturën elektronike nr. 38/2023, datë 06.07.2023 me vlerën 1.380.575 lekë pa TVSH me zërat: Plafona led 60x60 jashte muri 48w 4000k; Porto starter / neon 18-60 w; Droser / neon 18w; Llampe neon 18-220 V; Llampa led; Kabell 3x1.5 kunder vetedjegies; Multiprize shuko; Celes B-Polar 16A; automat, Nderpreres, magneto-termik; Salvavida; Nastro izolant; Kanaline 10x20 me ngjitje metër linear; Aspirator; Ndricules-prozhektor led; Trapan me Bateri; Komplet kacavida pinca elektrike; Indikator elektrik; Cante pajisjesh brezi; Percjellesa rryme; Kordon 2x1 mm, bateri alkaline; Kleme fundore; fasheta; Spot Led per gips 16Ë 4000K; Spot Led tavanor per gips 24-28 Ë 4000K; Aparat kunder insekteve Pest Repeller; Kurthe elektrike te insekteve fluturuese drite ultravjollce; Shkalle portative Al me 6 kate; Reostat ndricimi 220V;
20. Fatura elektronike nr. 105/2025, datë 18.12.2025 me blerës “Asi Invest” dhe vlerë 1.474.536 lekë pa TVSH për blerjen e artikujve Ushqyes, drita; Llampa led E27; terminale; Morsete; kabell; Kanalina; Manikota fi-; Tel kundra zjarrit; Kapak 3m i bardhe; suport; Llampe led 8-10 Ë E27 220V-400K; Gome karroce dore; Karroce dore; Ganzha bulieri; tubo; Dare karpentieri

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efijencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim

të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 8 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.5. Neni 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”. 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim. 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. 9 Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga

referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së, përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.6. Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pika 4, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.[...].”

III.1.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.8. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Fredri Electronic” SHPK, në përmbushje të kriterit për përvojat e mëparshme, KPP vlerëson se së pari,

norma juridike duhet të interpretohet e më pas të gjykohet, kjo për të analizuar në thelb ratio legis, kuptimin e drejtë të saj. Kështu, ligjvënësi ka parashikuar diskrecionin e autoritetit kontraktor të kërimit të dëshmime për eksperiencën e mëparshme, me synim për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Pra e drejta e dhënë nga ligji lidhet ngushtësisht me garantimin e autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik disponon dëshmi të përvojës së mëparshme për të realizuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për shërbime ligjvënësi në nenin 41, pika 3 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, të ndryshuar, ka parashikuar, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e vërtetimeve të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, dhe në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Gjithashtu, në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme.

KPP konstaton, se në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 të Shtojcës 9 të dokumentave të tenderit të sipërpërmendur, autoriteti kontraktor ka përcaktuar që në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar, a) me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të kryera, b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të kryera.

Në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik “Fred Electronic” SHPK ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik 5 eksperiencë të mëparshme të realizuara me sektorin publik të shoqëruara me faturat tatimore përkatëse dhe 15 eksperiencë të realizuara me sektorin privat me fatura tatimore, ku rezultojnë të dhënat mbi datat, shumat dhe furnizimet/shërbimet e realizuara.

KPP konstaton se zërat në faturat tatimore të paraqitura në ofertën e subjektit ankimues si më sipër cituar, në shumicën e tyre, konsiderohen të ngjashme me zërat përkatës në objektin e prokurimit të parashikuar në DT. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se operatori ekonomik “Fred Electronic” SHPK me dokumentacionin e paraqitur provon, se ka realizuar eksperiencë të ngjashme me objektin e prokurimit dhe ka plotësuar kështu kërkesën për kualifikim, për përvojë të suksesshme, pasi zërat në faturat e paraqitura, në pjesën më të madhe të tyre, janë të ngjashme me objektin e prokurimit si dhe vlera e tyre e tejkalon kërkesën e autoritetit kontraktor të përcaktuar në kriteret

e veçanta të kualifikimit si më sipër cituar. Synimi parësor i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet pjesëmarrëse në procedurën e prokurimit objekt - ankimi gëzojnë eksperiencë të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit dhe nuk synon favorizimin e shoqërive që kanë realizuar kontrata të njëjta identike.

Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në këto kushte, KPP gjykon, se operatori ekonomik ankimues, me dokumentacionin e paraqitur, e ka përmbushur kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor, shtojcën nr.9, pika 2.3.1, "Për kapacitetin teknik" në dokumentet standarde të tenderit, të procedurës së mësipërme të prokurimit.

Akoma më tej, vlen të theksojmë, se autoriteti kontraktor disponon të gjitha elementet e nevojshme procedurale si garanci, në rast të shkeljes së kontratës, konkretisht neni 83 "Sigurimi i ofertës" i Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe nenet 36 "Sigurimi i kontratës", të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se në bazë të nenit 124 "*Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës*" të LPP, si dhe nenit 107 "*Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës*" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse cilësia e shërbimeve dhe furnizimeve do të jetë e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuara në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të ligjit dhe rregullave për prokurimin publik, si më sipër cituar.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, "*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*", Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*", neni 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Fred Electronic” SHPK lidhur me procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-79574-03-18-2026, me objekt: “Shpenzime për mirëmbajtjen e qarqeve të ndriçuesve Led”, me fond limit 3,332,100 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 30.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Fred Electronic” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor të bëjë rivlerësim të procedurës së prokurimit në SPE, në zbatim të konstatimeve të KPP-së në këtë vendim.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera
5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Fred Electronic” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

